



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.602/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Skenderaj, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 24.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.602/2025, e datës 21.02.2025, e parashtruar nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me seli në Prishtinë, për shkak të parregullsive gjatë administrimit dhe numërimit të votave në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) në Prishtinë, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 21.02.2025, PZAP-i, është parashtruar ankesë nga subjekti politik, Lëvizja Vetëvendosje n të cilën pretendon se më 20 shkurt 2025, gjatë procesit të numërimit të votave në Sallën e Sporteve "Karragaçi" në Pejë, rreth orës 18.00, Komisioneri nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës Granit Husaj, ka thyer rregullat zgjedhore, i cili më pas, edhe është arrestuar nga Policia.Konkretisht, përderisa vazhdonte procesi i numërimit të votave dhe përderisa komisionerja nga radhët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! znj. Doruntina Shala, ishte në tavolinën e saj të numërimit, Komisioneri Husaj ka sulmuar verbalisht dhe ka kërcënuar e kanosur rëndë Komisioneren Shala, mes tjerash duke ju drejtuar me fjalët kërcënuese "të ngrehi zhag, lopë, psikopate..." dhe fjalë të tjera kërcënuese.Intervenimi i

Policisë ka parandaluar sulmin eventual fizik të Komisionerit të LDK-së Husaj ndaj Komisioneres së LVV-së Shala, me ç'rast Husaj është arrestuar dhe ka dhënë deklaratën në Stacionin Policor në Pejë, për dyshimet për veprat penale Sulm dhe Kanosje. Më tutje parashtruesi i ankesës thekson se rasti është i hapur në Polici për të cilin rast, po ashtu njoftuar Prokuroria Themelore në Pejë (nën menaxhimin e së cilës tashmë ndodhët rasti) dhe përkundër shkeljeve të rënda të rregullave zgjedhore dhe rastit të hapur në Polici dhe Prokurori për dyshimet për veprën penale "Kanosje", komisioneri Husaj në kundërshtim me dispozitat përkatëse zgjedhore, vazhdon të jetë i angazhuar në QKN në Sallën e Sporteve "Karragaçi" në Pejë. Parashtruesi i ankesës ka theksuar po ashtu se deklaratë në polici ka dhënë komisionerja Shala dhe si provë e ka përmendur Raportin e Policisë së Kosovës-Pejë për të cilin ka kërkuar që I njëjti të sigurohet zyrtarisht për shkak të pamundësisë tona përkundër përpjekjeve ndera prova tjetër që është përmendur në ankesës dhe I është bashkangjitur ankesës Fotografia e realizuar me 20 shkurt 2025 rreth orës 21:00 në QKN në Sallën e Sporteve "Karragaçi" në Pejë, në të cilën vrehët I rikthyer në QKN komisioneri Husaj.

PZAP iu drejtuar me kërkesë për përgjigje KQZ. Në përgjigje në ankesë të paraqitur nga KQZ-ja theksohet Për të pasur një pasqyrë më të qartë, lidhur me rastin konkret, KQZ, pas pranimit të kërkesës së PZAP, menjëherë ka kontaktuar me KKZ e komunës së Pejës , konkretisht me Kryesuesin e KKZ-së , i cili është Menaxher i Qendrës Komunale të Numërimit (QKN), duke pranuar përgjigjet dhe sqarimet si në vijim; Ju njoftoj se nuk kam qene prezent ne lidhje me rastin, policia ka intervistua dhe kanë vazhdua me numërim.KQZ, deri në tani nuk është njoftuar dhe nuk ka pranuar ndonjë raport nga Policia e Kosovës dhe Prokuroria e Shtetit, lidhur me rastin konkret. Në momentin që do të njoftohemi dhe do të kemi ndonjë raport nga këto dy institucione, do të veprojmë sipas ligjit për Zgjidhjet e Përgjithshmi dhe Ligjeve tjera ne fuqi në Republikën e Kosovës.Parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson Njoftimi i Menaxherit të Qendrës Komunale të Numërimit (QKN) në Pejë ,z.Abdurrahim Haxhisefa, ZE KKZ-Pejë, dërguar me e-mail më datën 23.022025 i cili përmes emailit thekson: Ju njoftoj se nuk kam qene prezent ne lidhje me rastin,policia i ka intervistua dhe kanë vazhdu me numerim.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi të gjitha shkresat e lëndës, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli i vlerësoi te paqëndrueshme pretendimet e parashtruara në ankesë nga subjekti politik LVV me të cilën pretendon se për shkak të parregullsive gjatë numërimit të votave në Sallën e Sportit “Karragaçi” në Pejë, Komisioneri nga radhët e LDK Granit Husaj ka sulmuar verbalisht dhe ka kanosur e kërcënuar rëndë Komisioneren nga radhët ec LVV znj.Doruntina Shala me fjalët kërcënuese “*të ngrehi zhag, lopë, psikopate*”, Paneli duke shqyrtuar ankesën dhe bazuar edhe ne përgjigjen në ankesë vlerësoi se ky pretendim ankimor është i paargumentuar, pasi qe duke marrë parasysh faktin se barra e provës i takon parashtruesit të ankesës andaj ne rastin konkret ankesës nuk i ka bashkangjitur asnjë prove për ti vërtetuar pretendimet ankimore (siq ka përmendur parashtruesi i ankese raportin policor apo ndonjë dëshmi – prove tjetër).

Ndërsa sa i përket pretendimit se i njëjti komisioner pas rastit është rikthyer prapë në QKN Pejë duke potencuar dhe orën 21:00 si orë e rikthimit të tij të , Paneli po ashtu vlerësoi se i njëjti pretendim nuk është i bazuar sepse nga prova e parashtruar - fotografia nuk mund të vërtetohet ora e sakte apo koha e mundshme e rikthimit të tij ne QKN. Andaj, duke u bazuar ne konstatimet e lartcekura Paneli e refuzoj ankesën dhe vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, pasi qe barra e të provuarit për faktet e pretenduara bie mbi ankuesin.

Nga të gjitha këto arsye e duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 par. 4, lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, lidhur me nenin 13 par.10 nënpar.10.1 të Rregullores së PZAP-së (Nr.01/2024), u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.602/2025, datë 24.02.2025

Kryesuese e Panelit

Kymete Kicaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.